



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 19 tetor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Munguan: Afrim Hoti.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm,

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 12. 10. 2011;
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, lidhur me veprimet e ndërmarra në përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it;
4. Shqyrtimi i njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të gjeturat e ZAP-it, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010;
5. Shqyrtimi i Raportit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 12 tetor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2011.

3 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, lidhur me veprimet e ndërmarra në përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it

Kryetari – Tha se Komisioni i Pavarur për Media ka kthyer raport për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjeturat e ZAP-it. KPM-ja ka reflektuar dhe ka avancim në shtjellimin e problemeve. Disa nga rekomandimet i ka adresuar, disa janë në proces, por ka edhe disa arsyetime për të cilat do të vendosë Komisioni. Pika dy, faqe 2 – KPM-ja thekson se “ZAP-i ka pretenduar”. Komisioni fjalën pretendim nuk e pranon, sepse ZAP-i ka konstatuar gjetje dhe këto nuk janë pretendime të ZAP-it. Sa i përket pikës, në të cilën thuhet se janë ndërmarrë masa disiplinore, kjo është diçka pozitive.

Mos regjistrimi i borxheve është pasojë e bartjes nga MF-ja. Procesi kur ka ndodhur memorandumit ka një justifikim, sepse ka qenë koha tejkaluese që ka reflektuar edhe te të tjerët dhe kjo vlerësohet pozitivisht. Faqe 3, realizimi i buxhetit – ka një sqarim, ka aneksin e memorandumit dhe ZAP-i e ka konstatuar këtë të gjetur, mirëpo edhe MF-ja e konfirmon këtë dhe si e tillë ka një justifikim. Shpenzimet për blerje me anë të prokurimit – nuk ka justifikim. Kërkesa për blerje, të pa detajuar, po ashtu nuk ka justifikim. Kërkoj nga ZAP-i që këtë ta përcjellë në proceset e mëvonshme dhe të kujdeset si do të reflektojë lidhur me këtë KPM-ja. Pohimi për zbatimin e procedurave të përshtetshme, po ashtu nuk është shumë bindës. Duhet të përcillet puna për këtë çështje dhe t’u ndihmohet, sepse ndoshta nuk e kanë kuptuar drejtë procedurën. Parapagimi për të shmangur suficitin e mundshëm, po ashtu nuk është e adresuar mirë.

Komisioni do të kujdeset që komunikimin ta bëjë nëpërmjet ZAP-it ose duke njoftuar ZAP-in. Kjo bëhet për faktin se Komisioni shqyrton raportet e ZAP-it dhe rezultati do të jetë më i mirë nëse edhe në këtë fazë komunikimi do të të bëjë nëpërmjet ZAP-it.

Hap diskutimin.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Në këtë fazë auditori nuk ka të drejtë të diskutojë publikisht rreth raporteve që i kryen kjo Zyrë, para se ato t’i dorëzohen entitetit të audituar. Kjo ka të bëjë me kodin e mirësjelljes dhe standardet e ZAP-it, që janë edhe standarde ndërkombëtare.

Ramiz Lladrovci – Vlerësoj punën e KPM-së, e cila ka reflektuar në pesë pika, ndërsa në pesë të tjera ka nxjerrë ZAP-in jo të saktë. Çmoj Raportin, por nuk e quaj të realizuar komplet, sepse p. sh.: ka dhënë mendim: “se veturat e KPM-së janë të njëjta dhe kanë goma të njëjta”. Kjo nuk është e pranueshme për Komisionin, sepse specifikacioni duhet bërë për çdo njësi. Ai nuk është i kënaqur me masat, vërejtje verbale, që ka ndërmarrë KPM-ja ndaj dy punëtorëve.

Komisioni duhet t’i dërgojë një letër kthyesë institucioneve, të cilat i janë përgjigjur kërkesave të Komisionit, me të cilën do të vlerësohet puna e tyre. Njëherësh duhet të paraqesë pakënaqësinë se disa nga rekomandimet nuk janë adresuar, siç është rasti me pesë nga rekomandimet e KPM – së. Pastaj Komisioni do të vazhdojë mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet gjatë shqyrtimit të raportit vijues të auditimit të këtyre OB-ve.

Armend Zemaj – Komisioni ka hyrë në një fazë të re dhe ka arritur të ngrejë nivelin e përgjegjësisë. Përgjigjet të cilat i ka dhënë KPM-ja me raport sado të përgjithësuar të jenë, kanë

rëndësi dhe kjo për disa arsye si: OB ka arritur të ballafaqohen me ata që janë për mbikëqyrje të financave publike. Kjo do t'i shërbejë si bazë Komisionit gjatë shqyrtimit të raportit të radhës të auditimit, për këto institucione. Sa i përket masave të ndërmarra ndaj punëtorëve - duhet marrë për bazë edhe ligjet e tjera të cilat parashohin shqiptimin e vërejtjeve me shkrim, pastaj masave më radikale, por për shkelje që përbëjnë vepra penale, ndoshta Komisioni ose kryetari i Komisionit, duhet të bëjë thirrje publike që institucionet përgjegjëse të marrin masa. Vlerësoj përgjigjet dhe marrjen e përgjegjësisë. Kjo është një pasqyrë e mirë edhe për auditorin për vitet e ardhshme të auditimit. Propozoj që mbi bazën e këtij Raporti Komisioni ta radikalizojë mbikëqyrjen.

Komisioni duhet të ketë kujdes në ndërtimin e praktikave të mira, sepse ky Komision është i ri dhe duhet të bëjë praktika të mira, në mënyrë që ato të vazhdojnë të mbesin të zbatueshme. Në këtë mes duhet gjetur një formulim të komunikimit të mirë në çdo instancë. Në bashkëpunim me ZAP-in, është shumë e domosdoshme që këto të gjetura duhet bëhen gjithnjë nëpërmjet ZAP-it, sepse ZAP-i është ai i cili vlerëson nëse janë adresuar rekomandimet ose jo. Përgjigja për këtë institucion duhet të jetë se Komisioni ka shqyrtuar raportin kthyes, por për disa nga to nuk është i kënaqur për përmbushjen e tyre.

Komisioni nuk duhet të kufizohet se me cilat përgjigje është i kënaqur, sepse përmbushja e rekomandimeve mund të bëhet vetëm nga ZAP-i. Raporti kthyes i KPM-së duhet t'i dorëzohet ZAP-it i cili pastaj, gjatë auditivit, do të verifikojë nëse të dhënat e KPM-së janë të sakta.

Valbona Dibra – Lidhur me Memorandumin e mirëkuptimit tha se është vërejtur se ky Memorandum nuk është zbatuar. Kërkoi sqarim nga ZAP-i se si e vlerëson situatën. Pastaj, mënyra e shqyrtimit të dytë të këtyre raporteve - si mund të japë vlerësim auditori i përgjithshëm, sepse këto gjëra kanë mundur të ndodhin para se të publikohet Raporti. Është afati prej dy javësh për konsultime midis entitetit të audituar dhe ZAP-it. Pra nuk ka pasur bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve dhe si pasojë e kësaj tani shumë gjëra po bien në kundërshtim. Shumë gjëra janë adresuar dhe këto kanë mundur të evitohen para se të publikohet Raporti.

Komisioni nuk duhet të marrë përgjigjet e OB-ve nga ZAP-i, sepse ky Komision është organi më i lartë mbikëqyrës të cilit i përgjigjet edhe vetë ZAP-i. Raportet kthyes të OB-ve janë për t'u vlerësuar. Kuptohet Komisioni duhet të bashkëpunojë me ZAP-in, por mënyrën e komunikimit të Komisionit me OB-të duhet ta bëjë Komisioni drejtpërdrejtë me OB-të. Tani shihet se edhe përgjegjësia e ZAP-it është më e madhe, sepse po ekziston një komision parlamentar mbikëqyrës para të cilit japin llogari për punë e tyre, si auditorët e ZAP-it ashtu edhe OB-të.

Komisioni duhet të formojë opinion në letër kthyes se për cilat nga rekomandimet Komisioni pajtohet se janë adresuar, e cilat nga rekomandimet nuk janë përmbushur. Auditori i përgjithshëm mund ta thotë mendimin rreth përmbushjes së këtyre rekomandimeve.

Në raportet sqaruese KPM-ja ka kontestuar disa nga të gjetura të ZAP-it. Tani si do të zgjidhet kjo? Cilit duhet besuar? Në këtë drejtim kërkoj përgjigje nga ZAP-i.

Murselj Haljilji – A ka pasur komunikim ZAP-i me këto tri institucione, sepse kjo është një gjë shumë e dobishme? Për ZAP-in është e domosdoshme të ketë informacione kthyes. Të gjitha OB-të duhet të marrin një shkallë të obligueshmërisë ndaj ZAP-it dhe ndaj Komisionit. Komisioni është instrumenti më i lartë për mbikëqyrje të financave publike. Por, ZAP-i, duhet të ketë informata të drejtpërdrejta nga OB-të, sepse në rastin e këtyre tri institucioneve ZAP-i nuk do të kishte informacione po të mos kujdesej për këtë stafi i Komisionit.

Lars Lage OLOFSSON – Drafti i është dërguar OB-ve të audituara për të shikuar faktet dhe për të arritur një pikëpamje të përbashkët për ato fakte. Pastaj finalizohet raporti i auditimit. Pas finalizimit të tij OB-të i kanë disa ditë kur duhet të përgatisin një plan veprimi, sa i përket rekomandimeve të ZAP-it. ZAP-i atë e merr për ta lexuar në fund të gushtit ose në fund të shtatorit. Nga ky vit entitet përgatisin pasqyrat nëntëmuore financiare deri më datën 30 shtator dhe MF-ja në qershor e ka dorëzuar një UA nr. 6/2011 ku tregohet se çka do të pasqyrohet në ato pasqyra nëntëmuore financiare. Një nga gjërat që OB-të duhet të pasqyrojnë në këto pasqyra financiare nëntëmuore - në një numër 20 - është rekomandimi nga auditorët, hapat ose veprimet

e marra ose të propozuara, afati për implementimin e tyre dhe ndikimi nga implementimi. Këto pasqyra financiare nëntëmuajore i dorëzohen Qeverisë dhe ZAP-it deri më 31 tetor. Raporte të veçanta, që ju keni kërkuar për këto që po shqyrtohen, nuk janë sjellë nga institucionet e audituara. Këto raporte ZAP-i i ka marrë nga Komisioni. ZAP-i nuk ka komunikim sa i përket planeve të veprimit të tyre. Kjo është përgjegjësi e tyre. ZAP është duke përcjellë këto dhe tani është duke kryer auditimin e ndërmjetëm, por ende nuk është finalizuar. Në MKK ende nuk ka filluar auditimi i ndërmjetëm, por do të filloj javën tjetër. Data e fundit për auditimin e ndërmjetëm-komunikim është fundi i dhjetorit. Me këto memo ZAP-i u ofron këshilla OB-ve se si duhet përgatitur pasqyrat financiare, pastaj ato japin këshilla si të adresohen rekomandimet e ZAP-it.

ZAP-i do ta ketë informacionin nga OB-të. Kjo është vetëm çështje kohe. Është obligim i tyre ligjor që ta bëjnë këtë dhe këtë e bëjnë të gjithë. Ai nuk mund të punojë me 100 institucione. ZAP-i duhet të kryejë auditim të ndërmjetëm në të gjitha këto OB. Është e pamundur nëse duam të bëjmë gjithçka në të njëjtën kohë. Komunikim ZAP-i ka me të gjitha OB-të. Përgjigjet e kërkesave të Komisionit për OB-të janë çështje e komunikimit ndërmjet Komisionit dhe OB-ve. Për këtë pastaj informohet ZAP-i, i cili përcjell zbatimin e rekomandimeve që të shihet mos kanë dhënë vetëm justifikime për disa fakte.

Ajo çka është prodhuar deri më tani nga KPM-ja është më shumë plan veprimi dhe shumica e gjërave ende nuk janë implementuar. Është shumë e rëndësishme për këtë Komision të kujdeset se çka është përmbushur realisht e jo për planin e veprimit.

Ata nuk kontestojnë të gjeturat, por po e justifikojnë vetën e tyre se nuk kanë bërë atë që do të duhej ta bënin.

Kryetari – KPM ka ofruar dëshmi rreth disa të gjeturave të ZAP-i, të cilat i ka kontestuar. Kërkoj nga ZAP- që t'i përcjellë këto dhe Komisioni do t'i mbikëqyrë përmbushjen e tyre gjatë vitit 2011.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike do t'i drejtohet me një letër kthyesë KPM-së, me të cilën do të shprehë vlerësimin se KPM-ja ka ndërmarrë veprime për përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it dhe të Kuvendit. Megjithatë disa nga rekomandimet mbesin ende të papërmbushura.

Komisioni do të vazhdojë të mbikëqyrë përmbushjen e rekomandimeve gjatë shqyrtimit të raportit të radhës të auditimit që do të kryejë ZAP-i në këtë institucion.

3. Shqyrtimi i njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës rreth të gjeturave të ZAP-it, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010

Kryetari – Ky institucion është një shembull i mirë për t'iu prezantuar edhe institucioneve të tjera se si duhet qasur rekomandimeve të ZAP-it dhe të Komisionit.

Valbona Dibra – Tha se edhe KGJK-ja në komentin numër katër ka kontestuar të gjeturën e ZAP-it. Kërkoj mendimin e auditorit lidhur me këtë.

Lars Lage OLOFSSON – KGJK-ja ka pranuar të gjeturën, por tani thonë diçka tjetër. ZAP-i me kohë do t'ju njoftojë lidhur me këtë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, do t'i përgjigjet KGJK-së me një letër kthyesë me të cilën vlerëson punën e KGJK-së rreth adresimit të të gjeturave dhe të veprimeve të ndërmarra. Komisioni pret njoftimin për përfundimet e veprimeve të ndërmarra.

4. Shqyrtimi i Raportit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010,

Kryetari - Ministria për Komunitete dhe Kthim e ka kthyer Raportin të kërkuar nga Komisioni. Personalisht nuk është i kënaqur me përgjigjet e kësaj Ministrie. Ndoshta do të duhej që këtë material ta marrë ZAP-i dhe Komisioni ta afatizojë këtë Ministri që në bashkëpunim me ZAP-in të ndërmarrë veprime konkrete dhe të japë përgjigje para Komisionit. Për këtë material duhet ngritur “flamuri i kuq”. Komisioni ka pasur vërejtje edhe rreth opinionit që ka dhënë auditori, sepse nga të dhënat del se pasqyrat nuk janë prezantuar saktë. Hap diskutimin.

Armend Zemaj – Tha se Ministria për Komunitete dhe Kthim me Raportin që i ka proceduar Komisionit, nuk ka arritur të sqarojë kërkesat e Komisionit.

Valbona Dibra – Tha se auditori ka standardet ndërkombëtare mbi bazën e të cilave jep opinionin. Në Raportin kthyes lidhur me të gjeturën që ka të bëjë me subvencionet dhe transferet thuhet “*si informacion lidhur me çështjen, nënshkrimi i raporteve nga vetë përfituesit e projektit*”, ministria është përgjigjur se kjo nuk është realitet. Sipas tyre kjo është argumentuar edhe para auditorëve, por ata nuk e kanë përfillur këtë. Megjithatë faktet ekzistojnë. Domethënë, Ministria ka vënë në pyetje të gjeturat e ZAP-it. ZAP-i duhet të caktojë takim me Ministrinë dhe të sqarojë këtë raport, pastaj të sqarojë Komisionin për të marrë një vendim.

Lars Lage OLOFSSON – Para se të finalizohet Raporti MKK-ja është pajtuar me gjitha të gjeturat. ZAP-i do të fillojë auditimin e ri dhe do të diskutohet gjithçka dhe Raport i tyre do të merret për bazë.

Lidhur me opinionin tha se misioni i auditorit të përgjithshëm është që të implementojë standardet ndërkombëtare të auditimit. Opinioni është për një gjë të tillë nëse pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale sjellin informacion të besueshëm dhe nëse ky institucion i përmbushur të gjitha obligimet për raportimin e jashtëm. Kjo është baza. MKK-ja ka dhënë pasqyra - informacionin e besueshëm dhe ata i janë përgjigjur kërkesave të UA-s të atij viti. MAPL nuk ka dhënë raporte tremujore dhe MF-ja nuk ka hartuar pasqyrat vjetore financiare me kohë.

Pra, cilësia e menaxhimit jep një ndikim mbi opinionin e auditimit.

Valbona Dibra – Tha se në rastin konkret auditori nuk ka pasur shans të devijojë në dhënien e opinionit, por në raste të tilla të të gjeturave duhet të bëhet praktikë që të bëhet auditimi i performancës.

Ramiz Lladrovci – Opinioni për MKK-në është jo i saktë. Po ashtu arsyetimi se pasqyrat financiare janë shpalosur saktë nuk qëndron, sepse në rekomandimin e dhënë nga ZAP-i, në konkluzionin përfundimtar, ka thënë se “*ministri duhet të sigurojë përmirësimin e nivelit të shpenzimeve aty ku vërehet performancë e dobët.*” Domethënë ZAP-i ka konstatuar performancë të dobët. “*Pastaj, ZAP-i ka dhënë shpalosjen e plotë të cilësisë së informatave - të pasqyrave vjetore financiare, forcimin e kontrollit lidhur me procedurat e prokurimit dhe të certifikimit të pagesave*”. Në bazë të këtyre të gjeturave Komisioni nuk është pajtuar me opinionin që ka dhënë ZAP-i. Ky opinion mund të jetë politik dhe nëse është i tillë Komisioni e pranon atë - e kalon atë, por, kjo nuk duhet të kalojë në heshtje. Raporti i MAPL-së ka qenë raport shumë më i mirë dhe opinionin ka qenë çështja është theksuar si duhet.

Kryetari – Tha se cilësia e informatave, sipas raportit të ZAP-it, fq. 8, pasusi i fundit, pasqyrat financiare ishin përgatitur sipas kërkesave të UA-së përveç mosshpalosjeve të avancave jo të

mbyllura dhe të shpalosjeve jo të sakta të vlerës totale të pasurisë. Pra ZAP konteston pasaktësinë e prezantimit të pasqyrave financiare. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Lars Lage OLOFSSON – ZAP-i nuk e mbështet opinionin se informacionet janë të ndikuara politikisht. Pra, nëse krahasojmë cilësinë e informacionit në MKK-së, në përgjithësi është në rregull, me përjashtim të shpalosjes së avancave të pambyllura dhe të aseteve pa ndonjë ndikim material. Nëse e krahasojmë me informacionin në MAPL, për të cilin ZAP-i ka thënë se ka pasur gabime materiale dhe kanë qenë të pasakta. Atyre u është dashur të ndryshojnë këtë, por edhe pas këtyre ndryshimeve në pasqyrat vjetore financiare, ishin disa çështje që kishin ndikim material në pasqyrat vjetore financiare, si të pagesat me palët e treta dhe për mënyrën si i kanë shpalosur pasqyrat financiare. Ata nuk i kanë ndjekur kërkesat e jashtme për raportimin e jashtëm. Theksimi i çështjes është ajo çka dua të paralajmërojmë lexuesin se diçka nuk shkon. Nuk ka të bëjë me vlerësimin se sa i mirë është menaxhimi financiar i tyre. Për Komisionin është me rëndësi se të dy rastet e para kanë të bëjnë me institucionet që ju raportojnë juve dhe rasti i tretë është organ që i raporton Qeverisë e cila është përgjegjëse.

Pra faktikisht nuk duhet të harroni se çka duhet të bëjë Qeveria sa i përket institucioneve që i raportojnë asaj. Ju jeni ata që duhet t'i kërkonit llogari Qeverisë për institucionet që i japin llogari asaj. ZAP-i kur të mbajë takim me menaxhmentin e MKK-së do të bëjë një auditim më të thellë dhe planifikimi për MKK-në për këtë vit, varësisht nga problemi në menaxhment, është më i madh se sa ka qenë më përpara.

Ramiz Lladrovci – Tha se vetm po te merret për bazë rekomandimi nr tre që thotë së pasqyrat financiare vjetore të shenzimeve të drekave zyrtare, të shpenzimeve të karburantit, të shpenzimeve për udhëtime zyrtare, opinionin do të duhej të ishte me theksim dhe kjo e bënë atë që në mbledhje plenare të deklarohet se auditri jep opinion të njënashëm.

Dhe diskutimet që po behën dhe atë që po kërkojnë anëtarët e Komisioni është që të krijohet një opinion dhe rekomandim më saktë për mbledhje plenare. Dhe bazuar në raportin e prezantuar nga ZAP-i duke mos mohuar profesionalizmin e auditorit, sepse pikërisht duke u bazuar në profesionalizmin e auditorit është keni nxjerr ky opinion.

Lars Lage OLOFSSON – Mangësitë që përmenden në rekomandimin tre janë me peshë. Ajo që thuhet nëpër mbledhjet e ekzekutivit është se ministri duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për t'i rishikuar dhe për t'i adresuar të gjeturat në raport. Këtë duhet ta bëjë ministri. Mangësitë e përmendura në rekomandimin tre nuk kanë ndikim material. Pra, opinionin është një gjë tjetër, kurse rekomandimet kryesore janë një gjë tjetër.

Kryetari – Tha se Komisioni do t'ia bëjë me dije Ministrisë dhe do t'i falënderojë për materialet e ofruara. Do t'ia bëjmë me dije se Komisioni ende mbetet me shqetësime se rekomandimet nuk janë shpalosur dhe ka nevojë për hapa shtesë. Inkurajohet që këtë ta bëjë Ministria.

Nga ZAP-i kërkoj që ta ndihmojë këtë Ministri rreth përmbushjes së rekomandimeve dhe kërkesave të Komisionit. Mbikëqyrja e rekomandimeve nga Komisioni do të bëhet gjatë shqyrtimit të raportit të viti pasues. Po ashtu kërkoj nga ZAP-i që këtë Ministri ta marrë me prioritet, sepse gjendja në të është shqetësuese.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

1. **Ministria për Komunitete dhe Kthim të ndërmarrë veprime konkrete për përmbushjen e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe për përmirësimin e gjendjes.**
2. **Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të përcjellë dhe të ndihmojë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në përmbushjen e rekomandimeve dhe në përmirësimin e gjendjes.**
3. **Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

4. Të ndryshme

a) Fushëveprimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike miratoi fushëveprimin e Komisionit si vijon:

- mbikëqyrja e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë publike në bazë të raporteve dhe të pasqyrave vjetore dhe periodike të audituara si dhe raportet e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrja e të gjitha raporteve të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike;
- mbikëqyrja e raporteve të performancës, të hartuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrja e raporteve të audituara dhe të performancës së shpenzimeve financiare të hartuara nga institucionet mbikëqyrëse të fondeve publike, të agjencive publike, të ndërmarrjeve publike dhe të instituteve publike të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike me anë të raporteve të Njësisë Qendrore të Harmonizimit (NJQH) të cilat nëpërmjet ministrit të Ekonomisë dhe të Financave i dërgohen Kuvendit dhe këtij Komisioni;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike, nëpërmjet raporteve të agjencive buxhetore, me kërkesë të veçantë të Komisionit;
- shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- kryerja e veprimeve në procedurën e përzgjedhjes së auditorëve të jashtëm, të cilët do të bëjnë auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- shqyrtimi i nevojave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa;

- Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve me anë të raporteve nga organizatat buxhetore;
- mbikëqyrja e zbatimit ligjeve nga fushëveprimi i tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

b) Mbledhja e radhës e Komisionit

Kryesuesi i Komisioni i njoftoi anëtarët e Komisionit se seanca dëgjimore mbahet ditën e hënë, më 24 tetor 2011, në orën 10:00. Të ftuar do të jenë ministri i Ministrisë së Financave, drejtori i Departamentit të Thesarit dhe NJQHAB si dhe kryetari i Bordit të KRPP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu